



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
KËSHILLI I BASHKISË

Datë 01.03.2024

Prot.16 (gjashtëmdhjetë)

Protokoll nr. 16

I mbajtur sot më datë 01.03.2024, në mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak Maliq, në sallën e mbledhjeve të këshillit të bashkisë, ora 10:00.

Rend Dite:

- 1.Hapja e mbledhjes (korumi, miratimi i rendit të ditës, vendimet e mbledhjes së kaluar);
- 2.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.
- 3.P-V “Për miratimin e Ndhmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin janar 2024”;
- 4.P-V “Për ndarjen e planit të bursave për arsimin profesional viti shkollor 2023-2024”;
- 5.P-V “Për miratimin në parim të Projektit “Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitetet të varfra dhe të pa favorizuara për vitin 2024”;
- 6.P-V “Për përjashtimin nga pagesa e vlerës së qirasë për vitin 2024-2025, të familjeve të cilat janë strehuar në banesa sociale”;
- 7.P-V “Për dhënie ndihme financiare për familje në nevojë”;
- 8.P-V “Për miratimin e Raporit të III-të të Monitorimit të buxhetit të Bashkisë Maliq për vitin 2023”;
- 9.P-V “Për detajimin dhe përdorimin e fondit të kushtëzuar për mbrojtjen civile”;
- 10.P-V “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB-në nr.26 datë, 26.12.2023 “Për miratimin e numrit të punonjësve, nivelin e pagave të administratës së Bashkisë Maliq dhe strukturave të tjera për vitin 2024”;
- 11.P-V “Për një ndryshim në VKB-në nr.34 datë, 30.03.2022 “Për krijimin e Këshillit Vendor Rinor dhe miratimin e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor Rinor si dhe mënyrës së organizimit dhe funksionimit të tij”;
- 12.P-V “Për disa ndryshime në VKB-në nr.40 datë, 11.06.2021 Miratimin e anëtarëve të Këshillit Bashkiak si pjesë e Komisionit Këshillimor “Për shqyrtimin e Titujve të Nderit, Kriteret dhe Procedurën e Dhëniës së tyre”;
- 13.Informacion për vendimmarjen, performancën e Këshillit Bashkiak Maliq viti 2023.
14. Diskutime të tjera.

Këshilltarë të pranishëm në sallë:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Ornildi Demollari; Petrit Kupe; Rudina Bregu; Floreta Zaçe; Ronaldo Skënderi; Pranvera Begolli; Gentiana Drabo; Aramando Dautllari; Danjela Ibrahim; Klea Baçi; Fevri Sherifi; Enida Avdolli; Xhuana Hoxhallari; Dritan Çami; Andonaq Risto; Aleksandra Spaho; Ildir Limllari; Dalina Krekas; Faslli Zholi; Albina Xhejo; Eglantina Balli; Neresida Shindo; Lulëzim Hoxhaj; Almir Elezi. 24 (njëzetëekatër) këshilltarë.

Mungesa: Plator Çollaku; Eriseld Jonusllari; Yllson Ibrahimllari; Ilia Xhuti; Rovena Terolli; Marainathi Avrami; Server Xhuti

Të pranishëm nga Administrata: Kryetari i Bashkisë; z. Gëzim Topçiu; Drejtore e Financës dhe Buxhetit: Almira Muka; Përgjegjëse e Sektorit të Shërbimit Social: Ermanda Petriti; Përgjegjës i Zyrës të Strehimit; Ledion Mullalli.

Ornildi Demollari: Përshëndetje të gjithëve! Të nderuar kolegë Këshilltarë, fillojmë këtë mbledhje të radhës të Këshillit të bashkisë Maliq, me rendin e ditës dhe materialet besoj se ju jeni njohur paraprakisht, I cili përbëhetet nga 14 pika, po të marrim dhe diskutime të ndryshme, mbledhja shoqërohet nga Kryetari i bashkisë, faleminderit. Para se të miratojmë rendin e ditës, dua tju bëj një propozim që P-V me karketer financiar ti kalojmë në fillim pika 8 të kalojë e 4 dhe pika 5 dhe pika 10 e 6.

Pranvera Begolli: Në emër të Komisionit të Mandateve propozoj të shtojmë dhe një pikë, ku do tju lexoj një raport hartuar nga Komisioni i Mandateve.

Ornildi Demollari: Jemi dakord me rendin e ditës, me ndryshimet e propozuara? E kalojmë në votim?

Kush është dakord ? 24 vota pro

Kundra? Nuk ka

Abstenim? Nuk ka

Miratohet me 24 vota pro rendi i ditës, Faleminderit!

Faslli Zholi: Të nderuar kolegë Këshilltarë, i nderuar Kryetar i bashkisë, i nderuar drejtues i seances.

Ornildi Demollari: Do flasësh në emër të grupit?

Faslli Zholi: Në emër të grupit do flasë znj. Eglantina. Ramë dakord që mbledhja të bëhet në date 1 dhe e mirëpritim konsensusin, por ne kishim dhe pika të tjera për ti futur në rend dite, zgjedhjet në Zvezdë dhe Drithas.

Ornildi Demollari: Nuk ke të drejtë të flasësh atëherër, do flasë znj. Eglantina. Faleminderit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Ornildi Demollari: Miratojmë Protokollin e mbledhjes së kaluar? Kemi miratuar shtatë vendime me karketer normativ të cilat kanë shkuar në Prefekturë dhe kanë marrë dakortësinë e Prefektit dhe gjashtë me karketer individual ose kolektiv. Miratojmë protokollin?

Kush është dakord ? 24 vota pro

Kundra? Nuk ka

Abstenim? Nuk ka

Miratohet me 24 vota pro rendi i ditës, Faleminderit! Kalojmë te pika 3 e rendit të ditës, P-V “Për miratimin e Ndhmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin janar 2024”; Ka ndonjë pyetje? Komisioni i Fianancës ka ndonjë sygjërim? Po.

Petrit Kupe: Dhe në mbledhje e kësaj radhe Komisioni Financës, u mblodh parapakisht, duke parë të gjitha problemet që kanë të bëjnë me fianancën dhe për sa i përket ndihmëse ekonomike, pati diskutim dhe u miratua totalisht ashtu si ishte propozuar. Kemi miratuar dhe një P-V për përfitimine reabilitimit të 46 banesave për familje në nevojë dhe këtu shprehim konsideratë si Komision për këtë proces që ka filluar prej 4-5 vjetësh, banesat financohen 80% nga buxheti i shtetit dhe 20% nga bashkia, emrat që përfitojnë janë gjykar drejt, njëkohësisht kemi diskutuar dhe P-V të tjera ai i përjashtimit të qirasë dhe ajo është është një ndihmë për ato familje. Miratua dhe P-V që ka të bëjë me strukturën dhe pagat, atje janë bërë disa ndryshime me pagat e miratuara në muajin Dhjetor dhe në kuadër të asaj që është shprehur Kryetari që në muajt në vazhdim do të ketë rishikim të pagave, ky është një rishikim i pjesëshme që ne jemi dakord të miratohet, por ajo që këmbngulim ne është që rishikimi i pagave dhe me ndryshimet ligjore të je të në qendër të vëmendjes nga bashkia, ju propozoj ti votojmë që të gjithë P-V me karketer financiar përmbushin të gjitha pritshmëritë tona.

Ornildi Demollari: Kryetar kishe diçka?

Kryetari i Bashkisë; z. Gëzim Topçiu: Për të saktësuar, kush ka mendim i hedhim në votim një dhe nga një P-V, në fillim ndihmën ekonomike, për të tjerat kam disa sqarime për të dhënë, më vjen mirë që Komisioni i Fianancës është në një linjë.

Eglantina Balli: Po shoh një ngërç këtu, ne ishim në mbledhjen e Komisionit të Mandateve dhe Rregullores, ne na parashtruan dorëhqejen e znj. Aleksandra, por unë shoh që ajo ka kartonin në dorë dhe është akoma duke votuar.

Kryetari i Bashkisë; z. Gëzim Topçiu: Është e vërtetë, por duhet një vendim Këshilli për këtë qëllim, sipas ligjit për vetë qeverisjen vendore, mandati i Këshilltarit jepet dhe hiqet me vendim Këshilli, ne deri në këtë moment nuk kemi një vendim Këshilli për heqje mandati. Ju u dakortësua ta kenë në rend dite në pikëne fundit.

Ornildi Demollari: E kalojmë në votim ndihmën ekonomike?

Kush është dakord ? 24 vota pro

Kundra? Nuk ka

Abstenim? Nuk ka

Miratohet me 24 vota pro, Faleminderit! Kalojmë te pika 8 e rendit të ditës, ashtu si ramë dakord, P-V “Për miratimin e Raporit të III-të të Monitorimit të buxhetit të Bashkisë Maliq për vitin 2023”; Ka ndonjë pyetje?



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Petrit Kupe:Në emër të Komisionit të Financës, ju propozoj ti votojmë që të gjithë P-V me karketer financiar përmbushin të gjitha pritshmëritë tona.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Kjo është një procedurë standarte që ne miratojmë çdo vit se çfarë ka ndodhur një vit më parë.Nëse ka pyetje? Drejtore i Fianancës Alma këtu është.

Ornildi Demollari:Drejtoresh do shtosh diçka? E kalojmë në votim?

Kush është dakord ? 24 vota pro

Kundra? Nuk ka

Abstenim? Nuk ka

Miratohet me 24 vota pro , Faleminderit! Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës, Pika 9, P-V “Për detajimin dhe përdorimin e fondit të kushtëzuar për mbrojtjen civile”; Ka ndonjë koment?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Ky fond na është çelur nga AKMC në vlerën 7.853.861.9 lekë, të cilën ja u kemi ndarë në dy objekte, një për të përballuar situata emergjente gjatë vitit, si raste zjarri, kemi menduar ta përdorim fondin dhe për ndërhyje në banesa kolektive që janë në rrezik, duke i vendosur çati.Duke u bazuar në VKM si trajtohen rastet e fatkeqësive dhe sa ju takon sipas përqindjes të dëmit, me këtë fond do mbulojmë dhe një shpenzim të vitit të kaluar, për të cilat marrëm vendim vitin e kaluar dhe nuk i fianacuam plotësisht, bëhet fjalë për banesat në fshatit Pendavinj dhe Plasë.Pjesa tjetër do shërbejë për rastet e tjera që do ndodhin gjatë vitit buxhetor, pjesa tjetër e fondit 4.3586 lekë, ju propozojmë ta përfshijmë për disa reabilitim objketesh, publike por dhe private kolektive, si soleta apo çati.Ne kemi miratuar një fond për këtë qëllim në buxhetin e vitit 2024, shtojmë dhe këtë fond dhe do kemi ndërhyje në disa pallate në Drithas, Libonik, Vreshtas, Velitërnë të cilat janë në situatë emergjente dhe përfshijnë VKM-në për rastë të tilla.Faleminderit!

Ornildi Demollari:Faleminderit Kryetar! Ka ndonjë pyetje tjetër? E kalojmë në votim?

Kush është dakord ? 24 vota pro

Kundra? Nuk ka

Abstenim? Nuk ka

Miratohet me 24 vota pro, Faleminderit! Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës, Pika 10, P-V “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB-në nr.137 datë, 26.12.2023 “Për miratimin e numrit të punonjësve, nivelin e pagave të adminsitratës së Bashkisë Maliq dhe strukturave të tjera për vitin 2024”;

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Nuk kemi shtesa në strukturë por vetëm disa rregullime pozicionesh dhe disa rregullime pagash, kemi një riformatim të zyrës të BE, e cila ka qenë në nivel specialistësh gjithë struktura, kemi kthyer një përgjegjës Sektorit i cili është detyrim ligjor, pozicionet e tjera mbeten ashtu si kanë qenë, kemi bërë një ndryshim pagae përgjegjësit Sektorit, nga 40.000 lekë, në 44.000 lekë, në lidhje me Sekretarin e Përgjithëshëm kemi njësuar pagën ashtu si e ka patur punonjësi kur ishte Nën/Kryetar bashkie, kemi bërë rregullime page dhe për specialsitin e prokurimeve me 44.000 lekë si gjithë specialistët e tjerë.Kemi sjellë ndryshimin e Teknik-Kompjuteri, ka qenë me shkollë të lartë, ja u kemi sjellë me shkollë të mesme për efekt dhe të mungesës të specialisteve me shkollë të lartë për këtë pozicion dhe na duheshe një Teknik



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

IT që mbulon gjithë bashkinë, kemi rregulluar dhe disa pozicione me 7-8 orë. Besoj se do gjej mirkuptimin e Këshillit për ta miratuar.

Faslli Zholi: Administrata e bashkisë ka më shumë punonjës apo ka më pak? A ka në bashki punonjës si në administratë dhe tjetër që kanë dale në pension dhe vazhdojnë punën?

Kryetari i Bashkisë; z. Gëzim Topçiu: Edhe pse pyetja ishte jashtë rendit të ditës, në çdo rast një administratë, ka vend për rishikim patjetër, shpesh herë përcillini informacion të gabuar, atje ku e adresoni. Dua ta sqaroj për qytetarët dhe Këshillin e Bashkisë, që Pylli i Fazanve nuk ka 14 roje, atje është nja nga Sektorët më të mirë që ka Bashkia, i cili mirëmban 55 ha pyll, i cili nuk dëmtohet më dhe tashmë është i vetmi vend turistik në bashki, patjetër që ka nevojë për rishikim. Unë jam kërkues për çdo punonjës, nga unë vetë deri te Sanitarja e shkollës. Ne kemi pozicione bosh në bashkis, si Inxhinerë dhe specialsitë të tjerë, sepse nuk gjen dot. A ka punonjës që kanë dalë në pension dhe janë në punë? Ligji i nënpunsit civil, nuk e lejon të jetë dhe në pension dhe i punësuar, për disa lloj pozicionesh që nuk janë me kod pune dhe pozicion politik, ligji e lejon edhe sikur të ketë dalë në pension, ne kemi nevojë për disa lloje pozicionesh, si Teknik Topograf etj.

Ornildi Demollari: Faleminderit Kryetar! Ka ndonjë pyetje tjetër? E kalojmë në votim?

Lulëzim Hoxhaj: Kam edhe unë diçka?

Ornildi Demollari: Komisioni i Financës foli, faleminderit nuk e ke fjalën.

Kush është dakord ? 23 vota pro

Kundra? Nuk ka

Abstenim? Nuk ka

Miratohet me 23 vota pro, Lulëzim Hoxhaj, nuk merr pjesë në votim. Faleminderit!

Kryetari i Bashkisë; z. Gëzim Topçiu: Për procedurë, nëse një Këshilltar ka një pyetje për P-V ose një sqarim kjo është e drejtë, nëse pastaj dalim jashtë rendit të ditës, nuk mund të lejohet. Nëse Luli, ka diçka për P-V dakord.

Ornildi Demollari: Luli, mund të shkojë të bëjë pyetje te Komisioni i Financës.

Lulëzim Hoxhaj: Komisionet vëret janë të rëndësishëm, para se të vijë materiali në Këshilli duhet të kalojë në Komisionet përkatëse, por kjo nuk do të thotë që është shteruese, në këtë Këshill ne vuajm sepse nuk flasim dhe nuk bëjmë diskutime. Në lidhje me P-V, unë parimisht jam dakord edhe për shtesat e pagave dhe të ketë rritje më të madhe, sepse nuk përputhen me realitetin. Problemi im është pak i veçantë, për administratën unë kam mendimin që me kalimin e kohës ajo duhet të vijë duke u zvogëluar, sepse kuptohet futet teknologjia, për rastin konkret jam dakord, por atë që doja të thoja, unë kam mendimin që duhet të shihet cilësia e punonjësve të administrates.

Kryetari i Bashkisë; z. Gëzim Topçiu: Patjetër që pagat e pushteti lokal, janë nga më të ultat nga të gjitha strukturat e tjera që ka administrata shtetërore në Shqipëri, në momentin që po flasim po punohet një ligj për pagat, ku do përfshihet edhe pushteti lokal, ne kemi në buxhet një vlerë prej 20 milion lekë, për të rishikuar pagat, por ne kemi mangësi specialsitësh në bashki si IT, Inxhinerë etj me këtë nivel pagash. Patjetër që gjithmonë ka vend për tu parë, por ne menaxhojmë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

81 fshatra, 57 shkolla, kemi problematika nga më të ndryshmet, e rëndësishme është që punonjësit të jenë efektivë.

Ornildi Demollari:Faleminderit Kryetar!

Pranvera Begolli: Komisionet kanë në përbërje anëtarë nga të dy grupimet politike dhe Kryetarët e grupeve të mbeldhin mendimin e Këshilltarve dhe tja dërgojnë Komisioneve.

Ornildi Demollari:Faleminderit!

Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës, P-V “Për ndarjen e planit të bursave për arsimin profesional viti shkollor 2023-2024”; Kryetar ke diçka?

Kryetari i Bashkisë; z.Gëzim Topçiu:Ne jemi të gatshëm të mbështesim çdo nxënës, në të gjithë territorin e bashkisë për ta trajtuar me bursë. I sygjeroj prindërve ti çojnë fëmijët sa më shumë në shkolla profesionale, për të garantuar një zanat.

Ornildi Demollari:Faleminderit Kryetar!

E kalojmë në votim?

Kush është dakord ? 24 vota pro

Kundra? Nuk ka

Abstenim? Nuk ka

Miratohet me 24 vota pro, Faleminderit! Shkojmë te pika 5 e rendit të ditës, P-V“Për miratimin në parim të Projektit “Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitetet të varfra dhe të pa favorizuara për vitin 2024”;Ka ndonjë pyetje?

Ornildi Demollari:Është ajo çka shpjegoj pak më parë Komisioni i Financës, bëhet fjalë për një projekt shumë të mirë që bashkia Maliq shpallet fituese për vitin e 4 apo të 5 dhe ju vjen në ndihmë familjeve të varfra.

Kryetari i Bashkisë; z.Gëzim Topçiu:Ky është projekti më i rëndësishëm që bashkia Maliq aplikon dhe fiton për disa vite me radhë dhe gjej rastin ti bëj apel çdo kujt që zotëron dokumenatacion dhe plotëson kriterin ekonomik të apilkojë pranë zyrave të bashkisë.Ka ndonjë problem? Patjetër që ka.Ky apel është dhe për Këshilltarët të na sygjerojnë emra, duke plotësuar kriteret patjetër.Sot po ju sjellim një preventiv dhe shpresojmë të shpallemi fitues, ashtu si jemi shpallur çdo vit nga aplikimet që ka bërë zyra e strehimit në bashki, ju kemi sjellë një listë me 49 emra, me një vlerë prej 85.8 milion lekë nga të cilat 20% i paguan bashkia, që janë parshikuar në buxhet dhe 80% i paguan Minsitria e Financës dhe Ekonomisë.Jemi duke mbyllur banesat e një viti më parë, kemi dhe një fazë këtë vit.

Idlir Limllari:Përsëritje! Kjo është diçka shumë e mirë, por kemi patur disa shqetësime nga disa qytetarë, që të pajisen me një tip leje ndërtimi, që mos kenë probleme me Policinë.

Kryetari i Bashkisë; z.Gëzim Topçiu:Patjetër që ai ka një dukumet, që vërteton që banesa do resturohet nga bashkia, patjetër që duhet të ketë një dokument nga ana Urbanistike se banesa ndryshon pamje dhe vlerë, nëse kërkohet dhe një vendim Këshilli, do e shohim patjetër.Të falenderoj për shqetësimin.

Ornildi Demollari:Faleminderit Kryetar! Ka ndonjë pyetje tjetër? E kalojmë në votim?

Fasli Zholi:Kam diçka dhe unë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Ornildi Demollari:Në emër të kujt do flasësh, fol në emër të grupit, për P-V, gjithëçka u ezauruar nga Komisioni dhe I dliri foli në emër të Komisionit të Strehimit.Unë nuk ta kam dhënë fjalën.

Kush është dakord ? 24 vota pro
Kundra? Nuk ka
Abstenim? Nuk ka
Miratohet me 24 vota pro, Faleminderit!

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Do ju sygjeroj ta gjenit gjuhën e përbashkët me njëritjetrin, kur ka një Këshilltar një shqetësim le ta ngrejë.

Ornildi Demollari:Shqetëimet ngrihen në mbledhjen e Komisionit përkatës, mbledhja e Këshillit është e strukturuar.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Kam dhe një sygjërim, të flasë Kryetari i grupit dhe më pas Kryetari i Komisionit përaktës dhe nëse ka ndonjë shqetësim nga ndonjë Këshilltar pastaj le ti jepet fjala.

Aleksandara Spaho:Ndodh që familjet që aplikojnë për rregullimin e banesës janë në proces gjyqësor për trashigiminë e banesës, deri sa përfundon gjyqi çfarë bëhet me këto shtëpi?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Ka një VKM dhe Udhëzim qeverie se çfarë kriteresh duhet të plotësojë një familje që të përfitojë nga kjo skemë.

Ornildi Demollari:Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës, P-V “Për dhënie ndihme financiare për familje në nevojë”;Janë gjashtë familje, na ka erdhur dhe një kërkesë, drejtuar Kryetarit të bashkisë dhe Këshillit bashkiak, te kjo pikë duhet të shtojmë dhe një familje nëse më lejoni, ka të bëjë me një fatkeqësi, rasti i aksidentit i banorit të fshatit Tërovë që ndroi jetë.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Ky është një P-V, që e ka sjellë Sektori i Shërbimit Social në bashki, do i propzoja Këshillit ta shtojmë dhe këtë familje që ka bërë kërkesë, që shpenzimet e varrimit të mbulohen nga bashkia, nuk e di sa është vlera, por ta shohim.

Jemi dakord ta kalojmë P-V me shtesën?

Kush është dakord ? 24 vota pro

Kundra? Nuk ka

Abstenim? Nuk ka

Miratohet me 24 vota pro, Faleminderit! Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës, P-V “Për një ndryshim në VKB-në nr.34 datë, 30.03.2022 “Për krijimin e Këshillit Vendor Rinor dhe miratimin e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor Rinor si dhe mënyrës së organizimit dhe funksionimit të tij”;

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Shumë mirë që kemi të rinj, le të krijojnë dhe ata Këshillat e tyre, të shtohen sa me sa më shumë anëtarë, të bëjnë sa më shumë aktivitete, ne po mundohemi të ngremë disa struktura, një prej tyre do realizojmë shumë shpjet në Rrëmbec katin e dytë të ish-Muzeumit, do kemi disa të tilla, si në Vreshtas dhe Qendra Koumintare në Maliq që



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

do jetë për të gjithë bashkinë, jemi duke menduar për një ndërhyrje të në Zëmbllak të ish-Qendra Shëndtësore për ta kthyer dhe atë në një zonë të tillë dhe ish-Kopshtin e Maliqit, janë disa projekte që po mundohemi ti përfshijmë me donatorë të ndryshëm.

Ornildi Demollari: Ka ndonjë pyetje tjetër? E kalojmë në votim?

Kush është dakord ? 24 vota pro

Kundra? Nuk ka

Abstenim? Nuk ka

Miratohet me 24 vota pro, Faleminderit! Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës, P-V “Për disa ndryshime në VKB-në nr.40 datë, 11.06.2021 Miratimin e anëtarëve të Këshillit Bashkiak si pjesë e Komisionit Këshillimor “Për shqyrtimin e Titujve të Nderit, Kriteret dhe Procedurën e Dhëniës së tyre”;

Kryetari i Bashkisë; z.Gëzim Topçiu:Duhet të bëni tre propozime deri në zbardhjen e vendimit, dy Këshilltarë nga Mazhoranca dhe një nga Opozita.Nën/Kryetari që kërkohet të jetë Enida Avdoli.

Ornildi Demollari: Ka ndonjë pyetje tjetër? E kalojmë në votim?

Kush është dakord ? 24 vota pro

Kundra? Nuk ka

Abstenim? Nuk ka

Miratohet me 24 vota pro, Faleminderit!

Ornildi Demollari:Ju lutem ka haruar një pikë, pika 6 P-V “Për përjashtimin nga pagesa e vlerës së qirasë për vitin 2024-2025, të familjeve të cilat janë strehuar në banesa sociale”;

Pranvera Begolli:Këto familje janë strehuar te ish-Kombinati i Sheqerit Maliq, janë familje në nevojë dhe duhet të ndihmohen, unë mendoj ta miratojmë që mos paguajnë qira.

Kryetari i Bashkisë; z.Gëzim Topçiu:Ne dhe kur kemi vendosur tarifën në fillim ajo ishte minimale, vetëm për mirëmbajtje, por këtë e lejon ligji ti lemë pa qira ato familje.

Ornildi Demollari: Ka ndonjë pyetje tjetër? E kalojmë në votim?

Kush është dakord ? 24 vota pro

Kundra? Nuk ka

Abstenim? Nuk ka

Miratohet me 24 vota pro, Faleminderit!

Kalojmë te pika 13 e rendit të ditës, Informacion për vendimmarjen, performancën e Këshillit Bashkiak Maliq viti 2023.

Ornildi Demollari: Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës, Diskutime të tjera. Pranvera si Kryetare e Komisionit të Mandateve, duhet ta lexoj materialin? Kalojmë te pika tjetër, leximi i raportit.

Pranvera Begolli:Pranë Komisionit të Mandateve, para disa kohësh kanë ardhur dy vendime Gjqësore, i Shkallës së Parë dhe Aplelit, që kishin të bënin me Këshiltaren tonë znj.Aleskandra Spaho.Por duke u vënë para faktit që Këshilltarja ka dhënë dorëhqjen e protokollar dje pranë bashkisë Maliq me nr.1990 Prot. Komisioni Mandateve u mblodh sot bër një raport, po ju lexoj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

raportin e hartuar nga ne, lidhur me heqjen e mandatit të Këshilltarit Bashkiak znj.Aleksandra Spaho, pas kërkesës për dorëheqje bërë nga znj.Aleksandra Spaho.

Raport:

Në zbatim ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", i ndryshuar, neni 49 "*Mandati i këshilltarit*" pika 2 dhe 5 gërma "b", dhe në zbatim të Rregullores së Këshillit Bashkiak Maliq miratuar me vendim këshilli nr.24, datë 12.03.2020, "*Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Bashkisë Maliq*", neni 21 "*Mbarimi para kohe i mandatit të këshilltarit të bashkiak*" gërma "b" dhe të shkresës të Znj.Aleksandra Spaho me lendë: "*Kërkesë për dorëheqje*" protokolluar pranë Bashkisë Maliq me nr.1190 Prot, datë 29.02.2024 dokumeneti bashkangjitur.

1. Miratimin e raportit për heqjen e mandatit znj.Aleksandra Spaho, kandidatë në listën shumemërore të Partisë Demokratike të Shqipërisë pas krijimit të kushteve për mbarimin e mandatit para kohe të Këshilltarit Bashkiak.
2. Sekretari i Këshillit të ndjekë procedurat e nevojshme ligjore për heqjen e mandatit dhe plotësimin e vakancës.

Raport i mbajtur sot më datë 01.03.2024 në Bashkinë Maliq, nga Komisioni i Mandateve Rregulloreve, Çështjeve Juridike, Qeverisjes së Mirë, Administratës, Zgjedhjeve, Strukturave Komunitare pranë Këshillit të Bashkisë Maliq, i përbërë nga:

Kryetar: Pranvera BEGOLLI

Anëtar: Petrit KUPE

Anëtar: Rudina BREGU

Anëtar: Neresida SHINDO

Anëtar: Eglantina BALLI

Pranvera Begolli: Po ju lexoj dhe kërkesën e bërë nga znj.Aleksandra Spaho, ky është raporti që kemi mbajtur. Për Këshillatret mbajnë përgjegjësi subjektet politike që i kanë propozuar. Ju faleminderit! Tani është në dorë të Këshillit për të miratuar raportin.

Lulëzim Hoxhaj: Nga informacioni Juridik që kam lidhë me këtë çështje, dorëheqja i është drejtuar KQZ, për djeni Këshillit Bashkiak, të marrë vendimin KQZ, ja dërgon Këshillit dhe më vonë marrim vendim, sot nuk kemi çfarë vendimi të marrim.

Pranvera Begolli: Ne sot miratojmë Raportin e Komisionit të Mandateve.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Lulëzim Hoxhaj: Mendoj që dhe Raporti i Komisionit të Mandateve nuk është korrekt, sepse dorëheqja i është drejtuar KQZ, për djeni Këshillit Bashkiak, nuk ka atribut Këshilli Bashkiak të marrë vendim.

Pranvera Begolli: Lexon me kujdes Ligjin dhe Rregulloren, kompetencat që ka Këshilli, neni 49 e thotë qartë arsyet pse hiqet mandati i këshilltarit. Këshiltari ka dhënë dorëheqje dhe detyrimisht do miratohet raporti.

Kryetari i Bashkisë; z. Gëzim Topçiu: Dua ta shpjegoj si e shoh unë këtë situatë jashtë pjesës së këshillit, jemi në një momenet që ky shqetësim ka erdhur nga grupi juaj, jo nga mazhoranca. Ajo çfarë ndodh me ligjin është, të drejtën për të hequr mandatin e ka Këshilli i Bashkisë, nuk lidhje KQZ, ligji 139/2015 parashikon se kur i hiqet mandati një Këshilltari dhe në momentin që Aleksandra ka dhënë dorëheqje vetë, në këtë moment Komisioni i Mandateve vihet në lëvizje për të përgatitur raportin për këshillin, nuk e heq as Komisioni i Mandateve. Komisioni i Mandateve sjell një raport dhe thotë jemi në këto kushte, kemi dy vendime Gjykate dhe dorëhqiën e saj. Në momentin që ajo do kishte diçka lidhur me vendimin ose me dokumentet, vetëm atëherë Komisioni i Mandateve mund ti drejtoheshe institucioneve të tjera, si KQZ apo Gjykatës për situatën Juridike, në këtë rast Këshilli duhet ta mendojë mirë këtë situatë. Nëse kërkon asistencë juridike nga ana e bashkisë, se çfarë parshikon ligji, jemi të gatshëm tja u japim, por në fund vendimin e merr Këshilli, nuk është P-V, apo material që paraqitet nga ekzekutivi.

Ornildi Demollari: Faleminderit Kryetar!

Lulëzim Hoxhaj: Në lidhje me këtë situatë, e kam konsultuar dhe me specialitet të KQZ, për procedure Aleksandra ka dhënë dorëheqjen dhe tani pritet vendimi i KQZ.

Ornildi Demollari: Sipas ligjit, nuk e heq KQZ mandatin, por Këshilli.

Aleksandra Spaho: Nëse KQZ do sjellë një shkresë, ku të thuhet ato që pretendon z. Zholi, por Këshilli nuk do votonte për heqjen e mandatit, si do vepron?

Pranvera Begolli: Ne sot do miratojmë raportin, për dorëheqje të znj. Aleksandra të Komisionit të ligjeve, të gjithë jemi koshientë që betimin e kemi bërë këtu dhe mandatin e kemi marrë në këtë sallë, KQZ sjell vetëm listë, mandatin e keni marrë këtu. Faleminderit!

Fasli Zholi: U tha dhe këto që kjo është bërë nga opozita, e kam përmendur dhe në media se me znj nuk asgjë personale, indicjen e kam marrë qyetetarët dhe pastaj e dokumentova me shkrim, kjo më është thënë nga qyetetarët që kanë qenë palë e dëmtuar në procesin gjyqësor.

Pranvera Begolli: Ju lutem kaloni në votim raportin.

Ornildi Demollari: E kalojmë në votim raportin e Komisionit të Mandateve?

Kush është dakord ? 20 vota pro



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Kundra? 3 vota.

Abstenim? Nuk ka

Miratohet me 20 vota pro, Faleminderit! Andonaq Risto, Almir Elezi, Lulëzim Hoxhaj votuan kundra.

Ornildi Demollari: Kjo ishte mbeldhja për sot.

Mbajtës Protokolli

SEKRETARI I KËSHILLIT

Gertjan GJIRTI

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI

